



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI KOMUNËS NË MALISHEVË



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNËS MALISHEVË
THE MUNICIPAL ASSEMBLY MALISHEVË



Komisioni Komunal për Dhënie në Shfrytëzim të

Pronës së Paluajtshme Komunale

Nr. 02/

Dt. 07.03.2019

PRANUAR:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

08/03/2019

02/147

Në bazë të nenit 5 të Ligjit nr. 04/L-144 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 7 të Rregullores QRK nr. 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës Nr.02/85 për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pishinës publike në fshatin Banjë, Komisioni Vlerësues për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale, më datë 07.03.2019, shpall:

NJOFTIM PËR ANKAND PUBLIK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR, TË PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE- PISHINËS PUBLIKE NË FSHATIN BANJË

EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

- Komuna Malishevës – Komisioni Vlerësues për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale;
- Adresa Rr.”Gjergj Kastrioti – Skenderbeu”, p.nr;
- Kodi Postar Malishevë 24 000.

LËNDA E ANKANDIT

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Malishevës, në bazë të Vendimit Nr.02/85, datë 07.02.2019 ka përcaktuar si qëllim dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale “Pishina Publike në Fshatin Banjë” personave juridik dhe personave fizik në afat prej dy viteve nga data e nënshkrimit të kontratës, përmes ankandit publik, procedura përmes ofertave të mbyllura.

Dhënia në shfrytëzim afatshkurtër (sipas Vendimit Nr.02/85, datë 07.02.2019) e pronës së paluajtshme komunale si vijon:

1. Prona publike e lartëcekur ndodhet në pjesën e Zonës Kadastrale në fshatin Banjë, KK-Malishevës, në sipërfaqe të përgjithshme prej 5147 m², e cila gjendet në pjesën e ngastrës kadastrale Nr.P-7231001-01692-1, në vendin e quajtur “Bazhlina te Bazeni”, pronë publike në emër të KK-Malishevës.



KRITERET E PËRGJITHSHME

1. Kriteri i dhënies së kontratës: Oferta më e favorshme ekonomike dhe me çmimin më të lartë;
2. Çmimi fillestar është **20,000.00 € (Njëzet mijë mijë euro)** për një vit;
3. Afati i dhënies në shfrytëzim të pronës është për dy vite nga data e nënshkrimit të kontratës;
4. Veprimtaria që ushtrohet në hapësirat e dhëna në shfrytëzim është kryesisht veprimtari rekreative dhe biznesi brenda hapësirave të përkufizuara sipas udhëzimeve të Drejtorisë për Shërbime Publike;
5. Sipas Vendimit Nr.02/85, të Kuvendit Komunal Malishevë, fituesi i Ankandit duhet të lirojë nga pagesa këto kategori (Familjet e ngushta të Dhëshmorëve, Invalidët e Luftës, Pensionistët, dhe Klubet i notit nga Komuna e Malishevës;
6. Fituesi i ankandit para nënshkrimit të kontratës duhet të paraqes policën e sigurimit apo garancionin bankar.

DOKUMENTACIONI NGA OFERTUESIT

Personat juridik

- Certifikatën e biznesit;
- Vërtetimin e tatimit në pronë;
- Kopjen e letërnjoftimit të pronarit;

Personat fizik

- Vërtetimin e tatimit në pronë;
- Kopjen e letërnjoftimit;

INFORMATA ADMINISTRATIVE

1. Afati kohor i fundit për tërheqjen e dokumentacionit nga ankandi: **data 05.04.2019 ora 15.00;**
2. Afati i kohor i fundit për pranim-dorëzimin e Aplikacioneve: **data 08.04.2019 ora 12.00;**
3. Vendi i dorëzimit të ofertave të ankandit publik: Komuna Malishevës, Qendra për Shërbime të Qytetarëve –Shkresorja e Komunës;
4. Takimi për hapjen e Aplikacioneve është publik dhe do të bëhet më datë **08.04.2019, ora 14.00;**
5. Ofertat hapen publikisht në sallën e Kuvendit Komunal – Malishevë të cekur si në pikën 4;
6. Ofertat duhen të jenë të shkruara me kompjuter e të njëjtat të dorëzohen të mbyllura në zarf dhe të regjistrohen sipas procedurës së pranimit të shkresave;
7. Informacionet shtesë mundë t'i kërkonit përmes zyrtarëve të Drejtorisë për Shërbime Publike;
8. Ofertat e mbyllura (dy kopje) në formë fizike dorëzohen në Shkresoren e Komunës së Malishevës.

Këshilla Juridike:

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë të Komisioni për Ankesa në Komunën e Malishevës, sipas dispozitave të nenit 9 pika 3 të Ligjit Nr. 04/L-144, Ligji për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunale.

Komisioni Komunal për Dhënie në Shfrytëzim të
Pronës së Paluajtshme Komunale Malishevë

Kryesuesi i Komisionit

Bashkim Krasniqi



